

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "RUBIX CAPITAL" Sh.p.k**

Ne Tirane, sot me date 09.03.2022(dymije e njezet e dy), nenshkruhet ky Akt Themelimi i Shoqerise " **RUBIX CAPITAL**" Shpk nga: "**Rubix Holding Group**" sh.p.k. shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar si person juridik prane qendres kombetare te regjistrimit Tirane me **NUIS M21508003D** me adrese. **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane**. E cila, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " **RUBIX CAPITAL**" Shpk.

**Neni 1**

**Forma e shoqerise**

Ortaket themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e secilit prej ortakëve është e kufizuar deri ne shumën e kapitalit te Shoqerise, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

**Neni 2**

**Emertimi i shoqerise**

Emertimi i shoqerise është "" **RUBIX CAPITAL** (RC)" Sh.p.k.

**Neni 3**

**Baza juridike**

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit dhe Aktit te Themelimit.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarise**

Veprimtaria e Shoqerise " **RUBIX CAPITAL**" Shpk do të ketë për objekt:  
Ushtrimin e aktivitetit te Institucioni Financiar te Mikrokredise dhe shërbimet këshilluese për veprimtarinë e kredihënies, sipas percaktimeve te legjislacionit shqiptar dhe rregulloreve te vecanta te Bankes Qendrore te Shqiperise. Shoqëria mund te kryejë cdo lloj veprimtarie tjeter që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Shoqëria, me vendim të Administratorit, dhe pas miratimit paraprak të Asamblesë së Pergjithshme, mund të lidhe marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

**Neni 5**

**Selia**

Selia e Shoqerise " **RUBIX CAPITAL**" Shpk është ne adresen: **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane. Shqiperi**.

**Neni 6**

**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

### **Neni 7**

#### **Kapitali i shoqerise**

Kapitali themeltar i shoqerise " **RUBIX CAPITAL**" Shpk eshte 50 000 (pesedhjetemije) Leke, dhe eshte depozituar ne nje llogari bankare te vecante sipas percaktimeve ligjore. Kapitali do të ndahet në 1 (nje) kuot. Ky kapital është formuar nga themeluesja e shoqërisë si më poshtë: "**Rubix Holding Group**" sh.p.k., me 50 000 (pesedhjetemije) leke duke zotëruar 100 % të kuotave 1 (nje kuot).

### **Neni 8**

#### **Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem me nje mandat 5(pese) vjecar.

Administratori i pare i shoqerise eshte Z. **Edmond Petraj**

Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njej ligji dhe Statuti i Shoqerise.

### **Neni 9**

#### **Te ardhurat**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se vitit ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

### **Neni 10**

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykatat e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, eshte hartuar ne 4 kopje ne gjuhen Shqipe dhe nenshkruset rregullisht nga ortaku themelues.

**ORTAKET THEMELUES: "Rubix Holding Group"**

**Administratori Edmond Petraj**

